

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve të shoqërisë për njësitë Gramsh-Belsh Peqin Cërrik-Librashd” të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Riparime mirëmbajtje dhe shërbime të lidhura me automjetet, 50100000-6 , pjesë këmbimi për automjete 34330000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 489 183, 333 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tre presje treqind e tridhjetë e tre) Lekë **pa TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UK Elbasan sh.a, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë-deklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetë-deklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetë-deklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajnë listën e dokumentacionit ligjor dhe administrative të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”. Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori duhet të ketë të përfshirë në Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit të kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022 ku vlera e xhiros për periudhën e kërkuar të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2020, 2021, 2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave dhe të konfirmuara nga ky Autoritet. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, mbështetur në VKM 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 41 pika 3. (neni 43/1/c në VKM 285)

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. (VKM 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43/3)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. (VKM 285, neni 55 pika 4/b)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të jenë shënuar, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 te ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 41 pika 3 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvijën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës në përbërje të të cilit të ketë jo më pak se 3 (tre) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

-1 (një) motorist

-1 (një) xhenerik

-1 (një) pompist

Për të vërtetuar se OE ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik me profilet e punës të cituara më sipër duhet të paraqesë:

- CV,
- Diplomë ose Certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme (për periudhën e zbatimit të kësaj kontrate)
- Të jenë të regjistruar në Listë-pagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore **për një periudhë jo më të vogël se 3 (tre) muaj nga data e zhvillimit te tenderit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41 pika 4/b dhe 4/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin/personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kësaj kontrate. Konkretisht referuar natyrës së shërbimeve që kërkohet të kryhen siç janë riparimi dhe mirëmbajtja e agregatit të motorit, karrocërisë, të sistemeve të drejtimit dhe të frenimit, kondicionimit amortizimit etj., është e nevojshme pasja e një stafi teknik me profesione si motorist, xhenerik, pompist, e vërtetuar kjo në bazë të kontratave të punës, si dhe me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, AK ka kërkuar që OE të ketë në stafin e tij punonjës të aftë specialist për realizimin e objektit të kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me kontratë qiraje të noterizuar dhe të vlefshme, për mjedisin e servisit ku ushtron veprimtarinë, dhe të përshtatshëm për kryerjen e shërbimeve objekt kontrate, **brenda territorit të Bashkisë Elbasan.**

Për këtë, OE duhet të paraqesë:

-Dokumentacionin që provon Pronësinë e objektit: ÇERTIFIKATËN E PRONËSISË SË OBJEKTIT (ku të jetë përcaktuar objekti: pikë servisi automjetesh, ose e ngjashme me të), me pronar subjektin ofertues,

OSE,

-Dokumentacionin e marrjes me qira apo në përdorim: KONTRATË QIRAJE apo HUAPËRDORJE me akt noterial, ku të vërtetohet e drejta e përdorimit të objektit (pikë servisi automjetesh) nga subjekti ofertues, të vlefshme minimalisht për periudhën e zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë DOMOSDOSHMERISHT në pronësi ose në përdorim ambiente për ushtrimin e aktivitet të tij, dhe në këto ambiente duhet të ekzistojnë të gjitha mjetet

e pajisjet e kërkuara. **Verifikimi i pikës së servisit, i pajisjeve dhe mjeteve të kërkuara do të bëhet në vend, nga ana e përfaqësuesve të “Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan” sha, përpara shpalljes së klasifikimit të ofertave.** Për këtë qëllim do të mbahet proces-verbal i veçantë që do të jetë pjesë e proces-verbalit të vlerësimit të ofertave nga KVO. Konstatimi i mangësive gjatë verifikimit në vend të ambientit, pajisjeve dhe mjeteve, përbën kusht për s’kualifikim të OE.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjedisi, mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate, është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të cilat duhet të dërgohen në mjediset e servisit, është e domosdoshme që OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht një mjedis për ushtrimin e veprimtarisë, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, dhe ky mjedis duhet të jetë në një vend/largësi të arsyeshme nga vend-qëndrimi i mjeteve të shoqërisë **me qëllim minimizimin e kostos kohore dhe ekonomike të transportit.**

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për makineritë dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion, të nevojshme për zbatimin e kontratës si më poshtë:

- 1 (një) Karroatrec në pronësi ose me qira për transportimin e automjeteve të defektuara në rastet kur automjetet nuk mund të shkojnë vetë në servis. Në lidhje me këtë pikë, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Dokumentin e Pronësisë (Leje qarkullimi ose certifikatë e pronësisë së mjetit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracion dhe të jetë i pajisur me tahograf), ose Kontratën e marrjes me qira apo huapërdorje me akt noterial, të vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës, të shoqëruar me dokumentin e pronësisë së qiradhënësit dhe dokumentacionin e plotë të mjetit (siguracion, leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe taksa të paguara).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë në dispozicion, apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të defektuar në pamundësi vetë-lëvizje për në mjediset e servisit që OE disponon, është e domosdoshme që OE të kenë minimalisht një karroatrec.

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të ketë në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, objekt i kësaj kontrate pajisjet si më poshtë:

- 3 (tri) Pajisje (ura) ngritëse për servis, të instaluar në objektin e servisit, nga të cilat 2 (dy) të kenë kapacitet ngritës deri në 3 (tre) ton, dhe 1 (një) me kapacitet ngritës jo më pak se 4 (katër) ton.

- 1 (një) Pajisje konvergjence (për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë së rrotave të mjeteve), të instaluar në objektin e servisit.

- 1 (një) Pajisje diagnostikuese të defektit të mjetit.
- 1 (një) Pajisje lëvizëse (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12 V dhe 24 V.
- 1 (një) Pajisje për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit.
- 1 (një) Pajisje për testimin e sistemit të ftohjes.

Për të gjitha pajisjet e kërkuara, OE duhet të ketë dokumentet provuese që i disponon këto pajisje. Dokumentacioni provues përfshin: pronësinë, ose të marra me qira, ose i ka në përdorim. Në rast se i ka marrë me qira, apo i ka në përdorim, duhet të ketë kontratë apo marrëveshje noteriale të vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 41 pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë në dispozicion, apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekti i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve ndër të cilat mund të ndodhë që në raste të caktuara duhet të riparohen më shumë se dy mjete në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh edhe punën ditore të OE, urat ngritëse janë parashikuar për vijimësinë normale të punës si nga sasia ashtu edhe nga kapaciteti mbajtës.

- Pajisja për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë së rrotave të mjeteve, është e nevojshme për konvergjençën e mjeteve, në funksion të rritjes së efikasitetit të punës dhe të uljes maksimale të konsumit të gomave.
- Pajisja diagnostikuese e defekteve, rrit efektivitetin e kohës së diagnostikimit dhe në saktësinë e përcaktimit të defekteve.
- Pajisja lëvizëse (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12 V dhe 24 V, nevojitet për rastet e mjeteve që kanë problem me ndezjen për shkak të mosfunksionimit të mirë baterisë.
- Pajisja për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit, shërben për ndërrimin e alkoolit të frenave të automjeteve, për të siguruar riparim, shërbim dhe funksionim sa më cilësor të këtij sistemi të rëndësishëm.
- Pajisja për testimin e sistemit të ftohjes, është e nevojshme për kontrollin dhe përcaktimin e defekteve të mundshme të këtij sistemi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë se garancia për pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë riparimit të automjeteve, do të jetë jo më pak se 1 vit nga data e daljes së mjetit nga riparimi.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate, synohet që mallrat (pjesët e këmbimit) që do të vendosen, të jenë të reja, origjinale ose ekuivalente, dhe minimumi të kenë 1 (një) vit garanci, dhe që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për Autoritetin Kontraktor, riparimin mirëmbajtjen dhe shërbim pa pagesë konform specifikimeve teknike sa herë lind nevoja, në një defekt të përsëritur.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që ofron shërbimin e kërkuar dhe në terren në rast nevoje të AK, përfshirë shërbimin e transportit për mjetet në rastet e defekteve në rrugë apo

për mjetet që nuk kanë mundësi vetë lëvizje, nga adresa e njësive të autoritetit kontraktor deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit, brenda vlerës së kontratës.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate, synohet që në rast se AK do t'i lindë nevoja për riparime në terren të hapur, në vende ku mjeti ka pësuar defekt gjatë zbatimit të grafikut apo urdhrit të punës, OE do të jetë i gatshëm të kryejë shërbimin në vend, nëse është e mundur transportuar atë në servis.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim

Njësia e Prokurimit